REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM
PËR FALJEN E BORXHEVE TË PA PAGUARA PËR ISH-SHFRYTËZUESIT E PRONËS KOMUNALE

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për faljen e borxheve të pa paguara për ish-shfrytëzuesit e pronës komunale të cilëve u kanë mbetur obligime të papërmbushura ndaj Komunës për periodën kohore 2000-2012.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi do të shlyhen- fshihen nga evidenca e borxheve të pa paguara të gjitha borxhet e ish-shfrytëzuesve të pronave komunale për periodën e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi të cilat figurojnë në pasqyrat financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

A r s y e t i m i

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat **e** nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Lipjanit i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës me datë 15.10.2026 për trajtimin e obligimeve të evidentuara në regjistrat financiarë të Komunës përkatësisht për ish-shfrytëzuesit të cilët figurojnë në regjistrat financiarë të Komunës me obligime të papërmbushura të evidentuara deri në vitin 2012.

Meqenëse, ka kaluar një kohë e gjatë e këto borxhe janë të vjetërsuara ku një pjesë e ish-shfrytëzuesve edhe kanë ndërruar jetë, mirëpo në pasqyrat tona financiare ende figurojnë si borxhe të mbetura, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi për faljen e borxheve siq theksohet në dispozitiv të këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 462/01-52705
Lipjan, më 19.10. 2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti